



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 69

Prishtinë, më 23.01.2013 ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N -302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Xhevahire Izmaqu, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Teuta Haxhiu, Afrim Kasolli, Ramë Vataj, Jeton Svirca dhe Milivoje Stojanovic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 12.12.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit, për vitin 2012;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, nr. 04/L-182, para miratimit në parim;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë, nr. 04/L-184, para miratimit në parim;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me shumicë votash pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 12.12.2012;

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 12.12.2012 u miratua pa verejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit, për vitin 2012

Kryetari i komisionit - i falënderoi anëtarët e komisionit për angazhimet e tyre për punën në komision duke theksuar se komisioni të cilin e udhëheq është komisioni më i ngarkuar në bazë të fushave që bien në fushëveprimtarinë e komisionit.

Xhevahire Izmaku - propozoi që në sesionin pranveror, komisioni të angazhohet më tepër në rolin mbikëqyrës të Qeverisë - ministrive si dhe në bashkëpunimin me ministrinë në rastin e shqyrtimit të p/ligjeve, ajo veçanërisht propozoi që në kohën kur do të rishikohet plani i punës, pas gjashtëmujorit të parë, anëtarët e komisionit të profilizohen për fusha të ndara në kuadër të fushëveprimtarive që komisioni i mbulon si dhe kërkoi që me rastin e zgjedhjes së ekspertëve, komisioni të përcaktohet për ekspert me të profilizuar.

Ramë Vataj - propozoi që në plan të punës së komisionit për vitin vijues të inkorporohet edhe P/ligji për diasporën.

Teuta Haxhiu – propozoi që komisioni të organizon takim me KPM-në duke përfshirë edhe takime të tjera me bordin për RTK-në dhe KPMSHCK-në.

Eqrem Kryeziu – shprehi kënaqësinë për punën e komisionit duke u deklaruar si pjesë e opozitës, gjithashtu tha se, kjo është meritë e kryetarit të komisionit.

Sadri Ferati - tha se në komision ka vullnet dhe klimë pune.

Jeton Svirca - tha se në komision ka hapësirë të punohet edhe më tepër, shqetësimi i tij ishte që mediat nuk e kanë përcjell punën e komisionit, kjo për arsye që opinioni të informohet se në Kuvend punohet.

Idriz Vehapi – duke i propozuar anëtarëve të komisionit që plani i punës të votohet, ai tha se komisionin e pret një punë që kërkon angazhime.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, nr. 04/L-182, para miratimit në parim;

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 23.01.2013 shqyrtoi në parim Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë :

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-182 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim, të Projektligjit nr. 04/L-182 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, vlerësojë së projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë, nr. 04/L-184, para miratimit në parim;

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 23.01.2013 shqyrtoi në parim Projektligjin për Administrimin e Punës në Zyrë, dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë :

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr .04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim, të Projektligjit nr04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, vlerësojë së projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

6. Të ndryshme

1. Në këtë pikë të rendit të ditës komisioni e shqyrtoi planin e punës për vitin 2013 dhe pas miratimit të tij, Ramë Vataj propozoi që Komisioni ti drejtohet me kërkesë MASHT-it që projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, i cili është paraparë sipas strategjisë legislative për shqyrtim dhe

miratim në Kuvend në muajin nëntor, MASHT-i ta sjellë në Kuvend para muajit qershor dhe kjo të bëhet në 3 mujorin e parë, në mënyrë që testi i sivjetmë të mbahet me ndryshime në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, ngase testi i maturës në vitin e kaluar është mbajtur me ndryshimet të cilat janë të inkorporuara në p/ligj d.m.th me dispozitat që nuk kanë qenë në fuqi.

2. Për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari i komisionit, i njoftoi anëtarët e komisionit për datat e vizitës që Komisioni do ta bëjë në Gjermani.

Mbledhja përfundoi në ora:12:45.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**